



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/30 Nr. i faq./Br.str./No.pg 76

Data/Datum/Date 28/03/2025

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, paragrafi 2, pika 2.11, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2022, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interesi të përgjithshëm publik të parcelës P-71510057-00095-6 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. **Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, Nr. 02/5422/25, i datës 18.03.2025 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik parcela kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-00095-6 në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe të përgjithshme prej 28m² (njëzetetë metra katror), në vendin e quajtur qytet-qytet, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në bashkëposedim të Negovan (Dushan) Vitosheviqit dhe Nemanja (Dushan) Vitosheviqit.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "zgjerimi e rrugës publike në qytet", e cila do të shërbejë për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
3. Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.30/25
Datë:28.03.2025

